

REPUBLIKA E SHQIPERISE
DHOMA KOMBËTARE E AVOKATISË
Dhoma e Avokatitë Tiranë
Av. Gjergji Habilaj
Licencë Nr.6360
Nr.28/01 akti.

Telefon: 00355682046895, E-mail:gjergji.habilaj@gmail.com
Tirane me 28/01/2021

**STATUTI I SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TE KUFIZUAR
"DARDANIA-PODUJEVA" SHPK.**

Sot, ne Tirane date 28/01/2021 ne respektim te kërkesave te Ligjit 9901, date 14.04.2008, "Për tregtaret dhe shoqëritë tregtare", dhe ligjt nr.9723 date 03.05.2013 "Per Qendrën Kombëtare te Biznesit", unë i nënshkruari:

- **DRITON ZHJEQI**, I biri i **SHEMSIUT** dhe i **MAGBULES** i datëlindjes 01.01.1965, lindur ne Podujevë, Kosovë dhe banues ne Podujevë , Kosovë, Rr. "Hasan Prishtina", Nr. 30 , Podujevë – Kosovë i identifikuar me karte identiteti me Nr. Personal : 1015840583 dhe ID:0384305, madhor , me zotësi te plete juridike për te vepruar, sipas aktit themelues dhe statutit ka vendosur formimin e shoqërisë tregtare me ortaket si me poshtë vijon.

Bazuar ne Ligjit 9901, date 14.04.2008, "Për tregtaret dhe shoqëritë tregtare", dhe ligjt nr.9723 date 03.05.2013 "Për Qendrën Kombëtare te Biznesit":

Shpallim themelimin e shoqërisë me përgjegjësi te kufizuar, si me poshtë vijon:

Neni 1

EMRI I SHOQËRISË

*Shoqëria quhet "**DARDANIA-PODUJEVA**" SHPK, person juridik .*

Neni 2

SELIA E SHOQËRISË

Selia e shoqërisë është ne Tirane , **Lagja: Rr. "Shyqyri Bërxollli dhe Besim Mema", Nr. 103 , Tirane .**

Me vendim te Asamblesë se Ortakeve, selia e shoqërisë mund te transferohet ne një rajon tjeter brenda territorit te Republikës se Shqipërisë. Gjithashtu, shoqëria ka te drejte te hape dege apo filiale ne te gjithë territorin e Republikës se Shqipërisë apo dhe jashtë tij.

Neni 3

KOHËZGJATJA E VEPRIMTARISË EKONOMIKE

Kohëzgjatja e veprimtarisë se Shoqërisë është e pakufizuar dhe fillon qe prej datës se regjistrimit te saj ne Qendrën Kombëtare te Biznesit.

Neni 4
OBJEKTI I VEPRIMTARISE

Objekti i veprimtarisë ekonomike i Shoqërisë Tregtare "**DARDANIA-PODUJEVA**" **SHPK** do te jete si me poshtë vijon:

1. Eksport-Import , tregtim me shumicë dhe pakicë ***karburante, gaz dhe të gjitha llojet e lëndëve djegëse.***
2. Veprimitari komisionarë, ndërmjetësimi, përfaqësimi, konsulencë për kompanitë e huaja dhe vendase .
3. Eksport-Import , tregtim me shumicë dhe pakicë materiale, ndërtimi, produkteve e industrial, veshmbathje, ushqimore, industriale, bujqësore dhe blegtoriale.
4. Eksport-Import , tregtim me shumicë dhe pakicë makina për transporte , për udhëtim , tokësor dhe detar, makina bujqësore, makina përpunuese të produkteve ushqimore bujqësore dhe blegtoriale , veshmbathje të të gjitha llojeve duke përfshirë edhe rroba dhe pajisje pune.
5. Eksport-Import , tregtim me shumicë dhe pakicë për të gjitha llojet e drurit si dhe përpunimin e tije si mobilieri, apo produkte ngrohje peleta , e tjera.
6. Eksport Import , blerje shitje mbeturina të ricliklueshme,të të gjitha llojeve , duke përfshirë edhe mbeturinat spitalore të cilat do të përdoren për djegie (prodhim energji nga nxehësia) , për qëllime industriale e tjera .
7. Shoqëria do të ushtrojë aktivitetin në fushën e ndërtimeve të ndryshme për strehim, ndërtimeve hotelerie, qendra turistike, objekti civile e tjera .
8. Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin edhe në fusha të tjera si më poshtë :
 - a. Studimi, projektimi, financimi, ndërtimi, menaxhimi i ndërtime civile, ekonomike, social-kulturore dhe industriale, ushtarake, tregtare, shtëpi banimi, infrastrukture, rruge, ura, kanalizime dhe ujësjellës, parqe industriale, aeroport ale etj.
 - b. Investime ne turizëm, ndërtim , hapje dhe shfrytëzim hotelesh, motelesh, bar-kafe, restorantesh, diskotekash, qendrash pushimi dhe kurative ne fushën e turizmit ne përgjithësi.
 - c. Agjenci dhe aktivitet imobiliar , shitje blerje te pasurive te paluajtshme si dhe te pasurive te luajtshme.
 - d. Aktivitet ne fushën e transportit te mallrave dhe pasagjerëve me mjetet e vete shoqërisë ose për llogari të të tretëve, hapje te agjencive turistike.
 - e. Hyrja ne marrëveshje dhe biznese me shoqëri te tjera qe kane te njëtin objekt veprimtarie.
 - f. Krijimi, blerja, financimi, investimi, hyrja ne marrëdhënie te ndryshme me te tretet, kryerja e sipërmarrjeve dhe projekteve, ofrimi i shërbimeve asistencës se te gjitha llojeve, personave fizike dhe juridike, përfshi shërbimet menaxhuese, këshilluese, planifikuese, financiare, turistike, teknike, administrative.
 - g. Kryerja e shërbimeve për vete dhe për te trete, rikonstruksione për vete dhe te trete, prodhimi i materialeve te ndërtimit dhe tregtimi i tyre me shumice dhe pakice.
 - h. Kërkimi, analizimi dhe përzgjedhja e personelit tekniko-administrativ. Punësimi i personelit te kualifikuar dhe vënia ne dispozicion te kompanive ndërkombëtare. Konsulencë juridike me kontraktor e huaj ne trajtimin e ligjeve shqiptare apo çështje te ndryshme ligjore. Konsulencë me kontraktorët e huaj ne kërkimin e personelit lokal tekniko-administrativ dhe vënia ne dispozicionin te kontraktoreve. Konsulencë me kontraktore te huaj dhe vendas për tenderimin e projekteve me financim te huaj.

- i. Shoqëria kryen çdo lloj veprimtarie te dobishme për arritjen e objektit te saj, duke përfshirë edhe pjesëmarrje ne kuota dhe aksione ne shoqëri dhe ndërmarrje te tjera.

Neni 5

Kjo shoqëri mund te ndryshoje emërtimin e saj, vendqëndrimin, objektin e aktivitetit, te shtoje ortake, te rrisë ose zvogëlojë kapitalin sipas vendimeve te organeve drejtuese te kësaj shoqërie.

Neni 6

KAPITALI I SHOQËRISË

Kapitali themeltar i shoqërisë është ne vleren e 100.000 leke, përbehet nga 1(një) pjese e cila zotërohet nga ortaku i vetëm Z. **DRITON ZHJEQI** 100 (njëqind për qind) të kuotave.

Neni 7

Kapitali i shoqërisë mund të rritet ne te ardhmen, nëpërmjet nënshkrimit dhe shlyerjes se kuotave te reja nga ortake te rinj, vetëm me vendim të ortakut të vetëm ose me vendim unanim te Asamblesë se Ortakeve te shoqërisë në rast se gjatë rrugës do të shtohen , ku do të miratohet si rritja e kapitalit themeltar ashtu dhe hyrja e ortakeve të ri. Ky kapital mund te shtohet sipas dispozitave ligjore dhe sipas vendimit te gjithë ortakeve.

Neni 8

Zvogëlimi i kapitalit themeltar të shoqërisë do te realizohet duke u bazuar ne dispozitat e veçanta qe parashikohen nga Ligji 9901, date 14.04.2008, "Për tregtaret dhe shoqëritë tregtare"

Neni 9 DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI

Shoqëria tregtare deklarohet e krijuar ne zbatim te plote te normave qe përmban ky Statut si dhe te legjislacionit shqiptar ne fuqi. Ajo konsiderohet e krijuar ne datën e regjistrimit ne Qendrën Kombëtare te Regjistrat.

Neni 10

Ortaku i vetëm i shoqërisë ose Ortaket e shoqërisë në rast shtimi gjatë rrugës , me krijimin e kësaj shoqërie pjesën e kapitalit te derdhur prej tyre nuk mund t'a térheqin. Kjo mund te behet vetëm pasi te nxirret bilanci i shoqërisë për fitimin e realizuar.

Neni 11

Në rastin e shtimit të ortakëve gjatë rrugës ,kuotat e çdo anëtari përputhen me pjesën e tyre ne kapitalin e shoqërisë. Kuotat e tij anëtari i shoqërisë mund t'ua ofroje te tretëve. Anëtaret e shoqërisë kane përparësi për blerjen e kuotave përpara personave te trete jashtë shoqërisë. Ortaku qe dëshiron te transferoje ose te shesë kuotat e tij i drejton një kërkesë me shkrim Organit Administrativ duke saktësuar çmimin e shitjes, i cili duhet te jete i arsyeshëm dhe te jete i njëjtë me atë qe do t'i ofrohet dhe një personi te trete jashtë shoqërisë si dhe te dhënat e blerësit. Organi administrativ jep përgjigje brenda 30 ditëve nga data e njoftimit dhe duhet t'ua

transmetoje ortakeve te tjerë ketë kërkesë dhe ortaket e tjerë duhet te japin një përgjigje brenda 3 muajve. Edhe e drejta e përparësisë për transferimin ose shitjen e kuotave duhet te ushtrohet me shkrim duke ju drejtuar Organit Administrativ.

E drejta e përparësisë për transferimin ose shitjen e kuotave është ne proporcion me kuotat qe zotëron secili prej ortakeve ne këtë shoqëri. Organi Administrativ pasi ka kaluar afati prej 3 muajsh, brenda 30 ditëve i komunikon ortakut qe shet kuotat e tij vendimin e ortakeve te tjerë për te blere te gjithë ose pjesërisht kuotat e tij. Ne rast se kuotat nuk shiten brenda shoqërisë, atëherë këto kuota brenda 90 ditëve i ofrohen personave te trete jashtë shoqërisë. Transferimi dhe shitja e kuotave duhet te bëhen me akte notieriale dhe një kopje e këtij akti duhet te depozitohet ne librin e Ortakeve.

Te gjitha transferimet e kuotave kane efekt mbi shoqërinë qe nga momenti i regjistrimit ne librin e Ortakeve dhe ne Qendrën Kombëtare te Regjistrat.

Neni 12

Emërtimi i shoqërisë tregtare, kapitali themeltar, emrat e administratoreve, si dhe emrat e Ortakeve , në rast se do të shtohen gjatë rrugës duhet te jene te përmendura ne te gjitha aktet e nxjerra nga kjo shoqëri dhe qe ju drejtohen te tretëve. Shoqëria ka vulën e saj me madhësi te zakonshme dhe me përbajtjen përreth saj.

Neni 13

Shoqëria vepron nen regjimin e pronës private dhe merr përsipër vete te drejtat dhe detyrimet kontraktuale dhe jashtë kontraktuale. Ortaku i vetëm dhe Ortaket tjerë në rast shtimi e shoqërisë drejtojnë procesin për zhvillimin e aktivitetit te shoqërisë si dhe për detyrimet qe ka shoqëria ndaj te tretëve pa asnjë kufizim.

Organet e shoqërisë janë:

- 1- **Ortaku i vetëm .**
- 2- **Asambleja e Ortakeve te shoqërisë në rast se gjatë rrugës do të shtohen.**
- 3- **Administratori .**

Neni 14 A S A M B L E J A E ORTAKEVE

Në rastin e shtimit të ortakëve gjatë rrugës , organi me i larte i shoqërisë është Asambleja e Ortakëve. Asambleja e ortakeve thirret nga administratori apo nga ortaket e përcaktuar sipas nenit 84 te ligjit 9901. Anëtaret duhet te njoftohen jo me vone se 7 dite përparrë datës se parashikuar dhe ne lajmërim duhet te jete shkruar vendi, ora dhe çështjet qe do te trajtohen. Ortakët, të cilët përfaqësojnë të paktën 5 për qind të totalit të votave në asamblenë e përgjithshme të shoqërisë, apo një pjesë më të vogël të parashikuar në statut, mund t'i drejtojnë administratorëve një kërkesë me shkrim, përfshirë postën elektronike, për të thirrur asamblenë e përgjithshme dhe/ose përfshirjen e çështjeve të posaçme në rendin e ditës.

Neni 15 TE DREJTAT E ASAMBLESË

Ortaku i vetëm ose Asambleja e ortakeve ne rastin e shtimit të ortakëve gjatë rrugës , ka kompetencat e mëposhtme:

- *Ka te drejte te beje ndryshime ne statut ne rast kur janë dakord ortaket qe përfaqësojnë tre te katërtat e kapitalit themeltar.*
- *Ka te drejte te miratoje bilancin e shoqërisë dhe te beje ndarjen e fitimit.*
- *Ajo emëron administratoret, zëvendësin, ekspertet dhe revizoret kontabël.*
- *Emëron ose nënshkruan kontrata bashkëpunimi me studio juridikë, ekspert , këshilltar vendas apo të huaj në përputhje me Ligjet e Shtetit Shqiptar.*
- *Ajo ka te drejte te beje përjashtimin e një ortaku nga shoqëria për rastet e parashikuara ne ligj si dhe ne rregulloren e brendshme te shoqërisë.*
- *Ajo aprovon çdo lloj veprimi finansiar qe me ligj dhe me marrëveshje lihet ne kompetence te Asamblesë.*
- *Përcaktion shpërblimin për administratoret, ekspertet, revizoret kontabël.*
- *Ben transferimin e kuotave te te tretet.*
- *Ben lidhjen e kontratave për dhënie dhe marrje te drejtash ose ekskluzivitet për tregtimin dhe prodhimin e mallrave te shoqërisë si dhe kontrata ne lidhje me organet shtetërore për pjesëmarrjen ne tender, ankande ose aktivitete te tjera te rëndësishme.*
- *Realizon blerje, shitje si dhe tjetërsim te pasurive te paluajtshme te shoqërisë etj.*
- *Ka te drejte te beje modifikimin e kontratës se shoqërisë.*

Neni 16

- *Asambleja e përgjithshme thirret kur shoqëria propozon të shesë apo të disponojë në mënyrë tjetër aktive, të cilat kanë një vlerë më të lartë se 5 për qind të aseteve të shoqërisë, që rezulton në pasqyrat e fundit financiare të certifikuara.*
- *Asambleja e përgjithshme thirret kur shoqëria, brenda 2 viteve të para pas regjistrimit të saj propozon të blejë nga një ortak pasuri, që kanë vlerë më të lartë se 5 për qind të aseteve të shoqërisë, që rezulton në pasqyrat e fundit financiare të certifikuara. Gjithashtu, këto dispozita nuk zbatohen në rastin kur shoqëria zotërohet nga një ortak i vetëm.*
- *Asambleja e përgjithshme mund të miratojë një rezolutë këshilluese, duke miratuar apo bërë vërejtje për veprimtarinë e administratorëve.*

Neni 17

Në rastin kur shtohen ortakët gjatë rrugës , kur pjesëmarrja ne asamble është normale vendimet qe merren brenda kufijve te kontratës se themelimit, Statutit e te ligjeve janë te detyrueshme për te gjithë, edhe për ata qe nuk kane diskutuar edhe për ata qe nuk janë dakord. Çdo ortak mund te përfaqësohet nga një ortak tjetër qe nuk është administrator. Asnjë i dërguar nuk mund te përfaqësoje me shume se një ortak.

Ne Asamblenë e Ortakeve marrin pjese nëse është e nevojshme për te dhënë mendim pa te drejte vote eksperte, revizore jurist e tjerë .

Neni 18

Ortaku i vetëm ose Asambleja në rastin e shtimit të ortakëve merr vendime te vlefshme ne rastet e parashikuara me poshtë:

a) Ne thirrjen e pare (mbledhjen e pare) ne praninë e ortakeve qe janë vete prezent ose te përfaqësuar nga persona te trete me prokure te posaçme dhe qe zotërojnë me shume se 1/2 e

kapitalit themtar.

- b) Në rastin e marrjes së vendimeve, që kërkojnë një shumicë të zakonshme, asambleja e përgjithshme mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse marrin pjesë ortakët me të drejtë vote, që zotërojnë më shumë se 30 për qind të kuotave. Në rastin kur asambleja e përgjithshme duhet të vendosë për çështje, të cilat kërkojnë shumicë të kualifikuar, sipas nenit 87 të këtij ligji, ajo mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse ortakët që zotërojnë më shumë se gjysmën e numrit total të votave janë të pranishëm personalisht, votojnë me shkresë, apo mjete elektronike, sipas parashikimeve të pikës 3 të nenit 88 të ligjit 9901. Nëse asambleja e përgjithshme nuk mund të mblidhet për shkak të mungesës së kuorumit të përmendur në pikën 1 të këtij neni, asambleja mblidhet përsëri jo më vonë se 30 ditë, me të njëjtin rend dite.
- c) Për ndryshimet ne Statut vendos Asambleja e Shoqërisë Jashtëzakonshme e ortakeve e cila merr vendime te vlefshme vetëm ne rast se këto vendime do te votohen nga sipas nenit 86 te Ligjit 9901, date 14.04.2008, "Për tregtaret dhe shoqëritë tregtare".

Neni 19

Marrja e vendimeve te Asamblesë, mbajtja e procesverbaleve dhe te gjitha dokumentet e tjera qe kane te bëjnë me te duhet te bëhen sipas legjisacionit ne fuqi për ketë qellim.]

Neni 20

ADMINISTRIMI

Shoqëria administrohet nga Administratori i cili caktohet ne statutin e shoqërisë dhe me pas nga ortaku i vetëm ose Asambleja e Ortakeve në rastin e shtimit të ortakëve gjatë rrugës. Administratori/et qëndrojnë ne detyre për një periudhe kohore prej 5 vjet dhe ne rast se gjate kësaj periudhe shfaqen probleme paaftësie nga ana e secilit prej tyre, Asambleja e Ortakeve vendos shkarkimin e administratorit përkatës duke treguar me fakte demin qe i është shkaktuar shoqërisë nga paaftësia e tij pasi është dhënë mendimi për këtë dem edhe nga specialistet përkatës.

Ata kane te gjitha kompetencat për te vepruar me te tretet ne emër te shoqërisë dhe ne interes te saj ne te gjitha rrethanat me përjashtim te kompetencave qe ligji dhe Statuti i shoqërisë u'a jep shprehimisht ortakeve.

Administratori/et kane te drejte qe te gjitha kompetencat e përmendura me sipër t'i ushtrojnë se bashku apo veç e veç duke qene përgjegjës individualisht ose solidarësh, sipas rastit, ndaj shoqërisë apo te treteve, për shkelje te ligjeve, për shkelje te statutit apo per faje te kryera gjate administrimit te shoqërisë.

Ata nuk mund te marrin vendime te rëndësishme siç janë huate, te shesin pronat e shoqërisë, apo te bëhen dorëzanes ne emër te saj. Ata nuk mund te kryejnë veprime te cilat i lihen ne kompetence Asamblesë se Ortakeve.

Asambleja mund te vendose lejimin e nje shpërblimi ne favor te Administratorit per kryerjen e detyrës përveç pagimit te shpenzimeve.

Administrator i shoqërisë eshte Z. DRITON ZHJEQI

Neni 21

Administratori/et mund te emërojë një ose me shume administratore te deleguar ose përfaqësues te thjeshte për te kryer veprime te veçanta duke përcaktuar fuqinë e tyre brenda kufijve e duke e respektuar statutin dhe ligjet ne fuqi dhe vendos dhënien e një shpërblimi ne favor te tij. Detyrat e tyre do te përcaktohen ne një rregullore te brendshme te shoqërisë.

Neni 22

Administratoret kane liri te plote për drejtimin e zakonshëm dhe te jashtëzakonshëm te shoqërisë dhe mund te kryejnë te gjitha llojet e veprimeve dhe cdo lloj marrëveshje per realizimin e qëllimeve te shoqërisë duke përashtuar rastet qe jane te parashikuara ne ligj dhe ne Statut qe i takojnë Asamblesë se Ortakeve.

Neni 23

Administratoret kane te drejte te nënshkruajnë për kapitalin e shoqërisë, kontrata te ndryshme, per furnizime publike private, te ndërmarrin veprime gjyqësore per dhe ne emër te shoqërisë, etj. Administratori mund te japid prokura ne kufijtë qe i lejon Asambleja e Ortakeve per kategoritë te caktuara veprimesh.

Administratoret janë te detyruar te mbajnë regjistrat e magazinimit te cilat vihen ne dispozicion te organeve kopetente per te mundësuar kryerjen e kontrolleve prej saj. Administratoret e shoqërisë janë te detyruar te mbajnë inventar te rregullta një here ne muaj. Raporti i administrimit, inventari dhe llogarite vjetore, hartohen nga Administratoret.

Neni 24 MARRËDHËNIET E PUNËS

Marrëdhëni e punës rregullohen nëpërmjet kontratës se punës së punës apo kontratës së porosisë të secilit dhe legjislacionit te punës ne fuqi. Shoqëria private merr përsipër te respekojoje rregullat ne fuqi te punësimit dhe te punësuarit janë te detyruar qe te respektojnë Statutin e kësaj shoqërie dhe rregullat e brendshme te saj. Te punësuarit duhet te përgjigjen për demet qe i shkaktojnë kësaj shoqërie nga veprimet ose mosveprimet e tyre sipas ligjit.

Neni 25

KONFIDENCIALITETI, RUAJTJA E SEKRETIT

Konsiderohen si konfidenciale dhe nuk lejohet te behet publike përbajtja e tyre për te tretet e te gjitha akteve dhe dokumenteve qe janë përcaktuar si te tilla nga administratoret e kësaj shoqërie.

Neni 26 EKSPERTET OSE REVIZORET KONTABËL

Kontrolli mbi veprimtarinë e Administratorit, veprimtarinë e tij si dhe gjithë aktivitetin e shoqërisë i besohet një eksperti ose revizori kontabël. Ky ekspert do te qëndroje ne detyre per aq sa përcaktohet me ligj dhe mund te rizgjidhet. Ortaku i vetëm ose Asambleja e Ortakeve në rastin e shtimit gjatë rrugës cakton dhe shpërblimin përkatës kur nuk ka norma te veçanta ligjore.

Neni 27
BILANCI DHE FITIMET

Veprimtaria ekonomike e shoqërisë do te mbylljet ne dt. 31 Dhjetor te çdo viti. Administratori merr masa për hartimin e bilancit dhe rezultatin ekonomik fitim - humbje dhe inventar. Pasi veçohen fondet si me sipër dhe paguhën detyrimet fiskale, te ardhurat qe mbeten në llogarinë e ortakut të vetëm ose ndahen midis ortakeve në rast të shtimit të tyre gjatë rrugës dhe mund te transferohen lirisht jashtë shtetit sipas dispozitave përkatëse ligjore.

Neni 28

Ne rast se kapitali i shoqërisë për shkak te humbjeve te realizuara rezulton me pak se kapitali themeltar, ortaku i vetëm ose pronaret në rastin e shtimit gjatë rrugës ,vendosin brenda 4 muajve për mundësinë e prishjes se shoqërisë.

Neni 29
SHPËRNDARJA DHE LIKUIDIMI I SHOQËRISË

Ne rast se shoqëria prishet për çdo lloj arsyre ortaku i etëm ose Asambleja e Ortakëve në rastin e shtimit gjatë rrugës përcakton mënyrën e likuidimit, emëron një ose me tepër likuidator dhe përgatit te gjitha dokumentet e nevojshme për çregjistrimin e saj nga Registri Tregtar.

Neni 30
DISPOZITA TE PËRGJITHSHME

Për sa është shprehur ne ketë statut i referohemi Ligjit 9901, date 14.04.2008, "Për tregtaret dhe shoqëritë tregtare", Statutit dhe rregullores se brendshme te shoqërisë. Çdo ndryshim behet ne te njëjtën mënyre siç është nxjerre ky Statut dhe nuk prek personalitetin juridik te kësaj shoqërie.

Ky statut nënshkruhet rregullisht nga ortaku i shoqërisë ne Tirane , sot me 28/01/2021 dhe hartohej në tre kopje, një nga të cilat ngelet në dosjen e studios juridike.

ORTAKU I SHOQËRISË "DARDANIA" SHPK .

DRITON ZHJEQI

Driton Zhjegi
DZ

Përgatiti STATUTIN E SHOQËRISË

Avokat & Ndërmjetës

Dr. Gjergji Habilaj

